



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:156816

Datë: 15.05.2024

Numri i dokumentit: 05689176

Ac.nr.4279/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Liridon Maloku, kryetar i kolegjit, Burim Shala dhe Naim Mehulli, anëtar, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.H, të cilin e përfaqëson me autorizim avokati I.G, kundër të paditurës “L.P” sh.p.k., me pronar N.D, të cilin përfaqëson me autorizim avokati V.S, për kompensim dëmi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan C.nr.427/17 e datës 11.03.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 13/05/2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa themeltë ankesa e të paditurës L.P” shpk, dhe VËRTETOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan C.nr.427/17 e datës 11.03.2021.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktgjykimin ankimor C.nr.427/17 e datës 11.03.2021, ka vendosur si vijon:

I.APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar kërkesëpadia e paditësit A.H L, dhe DETYROHET e paditura L.P” shpk me numër fiskal NRB 71324966 dh numër fiskal NRF 60169246 me pronar N.D që paditësit, që në emër të kompensimit të dëmit, për aksidentin e dt.16.12.2016, për përgjegjësinë prej 70 % t’i paguaj paditësit shumat e specifikuar si më poshtë:

Për dëmin jomaterial:

Në emër të dhimbjeve trupore-fizike shumën prej.....2300-€
Në emër të frikës së përjetuar shumën prej.....1500-€,
Në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumën prej.....1200-€

Për dëmin material:

Në emër të ndimës dhe kujdesit të huaj shumën prej.....250.00-€
Në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej300.00-€

Në emër të rehabilitimit fizioterapeutik shumë prej.....154.00-€

Të gjitha këto në afatin prej 15 dite nga dita e marrjes në dorëzim të këtij aktgjykimi e deri te pagesa definitive.

II. DETYROHET e paditura që paditësit, t'ia kompensoj shumë e përgjithshme në lartësi prej 5704.00-€, me kamatë ligjore prej 8%, e cila fillon të rrjedhë nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e deri në pagesën definitive, si dhe në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore shumë prej 1198.80-€, si dhe taksës gjyqësore për padi në shumë prej 60-€, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me detyrim.

III. Pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit A.H mbi shumën e aprovuara sikurse në dispozitivin I të këtij aktgjykimi refuzohet si e pabazuar.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka paraqitur i autorizuari i të paditurës, duke e atakuar të njëjtin për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit të aprovoj ankesën si të bazuar, ndërsa aktgjykimin e atakuar ta prishë dhe lëndën t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim ose të ndryshoj në atë mënyrë që shumën e gjykuara ti zvogëlon për të gjitha llojet e demit.

I autorizuari i paditësit ka parashtruar përgjigje në ankesë, me propozim që të refuzohet ankesa e të paditurës.

Gjykata e Apelit e Kosovës si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar dhe komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, përmes të autorizuarit të tij, në gjykatën e shkallës së parë, me datën 14.09.2017, ka paraqitur padi kundër të paditurës "L.P" shpk, me pronar N.D, për kompensim demi, me kërkesë të precizuar si në parashtrësën e datës 28/01/2021.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse si dhe të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitivin e të njëjtit. Në arsyetimin e aktgjykimit të ankimit gjykata e shkallës së parë ka theksuar se paditësi me dt. 16.12.2016, rreth orës 16:00, derisa ishte duke kryer punët dhe detyrat punës, në objektin e ndërtimit në "Suhadoll rr" Ismet Asllani, ka rrëshqitur dhe është rrëzuar në tokë në lartësi prej 3-4 m, ku toka ka qenë me akull dhe lagështi të madhe, e në këtë rast paditësi nuk ka pasur mjete personale të mbrojtjes në punë, dhe me këtë rast ka pësuar lëndime të rënda trupore, të cilin fakt e ka vërtetuar edhe Raporti Zyrtar i Inspektoratit të Punës, të cilës provë gjykata ia fali besimin në tërësi. Nga ekspertiza e Ekspertit të Sigurisë në Punë, Gjykata ia fali besimin plotësisht, sa i përket konstatimeve për lëshimet e të paditurës sa i përket: mos informimit të Inspektorit të Punës, mos informimit dhe mungesës së trajnimeve dhe udhëzimeve për punë, si dhe konstatimeve – kontrollit të gjendjes shëndetësore të punëtorit, si dhe sa i përket vlerësimit të gjendjes faktike – mënyrës së lëndimit të paditësit si dhe lëndimi ka ndodh në Ndërmarrjen "L" shpk, nuk është formuar komision për

vlerësimin e lëndimeve në punë, ndërsa sa i përket përgjegjësisë –lëshimeve të paditësit si: vigjilenca joadekuate personale, moskujdesi adekuat nga aspekti i Mbrojtjes dhe Sigurisë në Punë, moskujdesi adekuat gjatë ngritjes së shtyllës metalike, mospërdorimi i mjeteve të mbrojtjes personale në punë, e rëndësishme për vërtetimin e lidhjes kauzale ka qenë fakti se paditësi me këto veprime të lartcekura veprime të tij, në kundërshtim me rregullat e punës, të ketë kontribuar në shkaktimin e lëndimit – elementi i shkakut. Gjykata duke u bazuar në gjendjen e vërtetuar faktike si më lartë, vlerësoi se e paditura ka përgjegjësi prej 80 % për dëmin që i ka shkaktuar, palës paditëse, me rastin e lëndimit, dhe dëmit të pësuar, në aksidentin e lartëcekur, për çka e paditura është e obliguar që ta kompensoi mbi bazën e përgjegjësisë, e lidhur me dispozitat e nenit 136.1, 152 par.1, 169, 176, 179 ,183 dhe 382 të LMD-së, me nr.04/L-077, si dhe në bazë të nenit 6.3 të Ligjit nr.04L/161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë. Gjykata e mori në tërësi si të bazuar dhe ia dha besimin e plotë ekspertizës së lartpërmendur, nga se ekspertiza i përmban elementet e nevojshme të dhëna mbi bazën e njohurive profesionale dhe arsye te mjaftueshme të cilat gjykata i vlerësoi si të drejta për vërtetimin e fakteve vendimtare ne këtë çështje kontestimore. Vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore i ka marr konform nenit 449 dhe 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pikat (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK, dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, e për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala e paditur me ankesë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit i pathemeltë qëndron pretendimi ankimor i palës ankuese për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të paraparë me nenin 182 par.2 pika n) të LPK-së, ngase aktgjykimi i ankimuar del se nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet sepse dispozitivi i aktgjykimit është i qartë e në harmoni të plotë me arsyetimin e aktgjykimit. Në arsyetim të aktgjykimit po ashtu janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë, e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsyeje të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për gjendjen faktike të konstatuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, sepse në bazë të provave të administruara e sidomos nga ekspertiza mbi vlerësimin e rrethanave të aksidentit në punë të datës 12/08/2020, vërtetohet se deri te aksidenti i ndodhur në vendin e punës ka ardhur si rezultat i lëshimeve primare të paditurës dhe lëshimeve sekondare të paditësit, ku këtë përgjegjësi gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka ndarë si vijon: 20 % për paditësin të cilat lëshime konsistojnë në atë se paditësi nuk e ka pasur kujdesin e shtuar gjatë punës dhe nuk i ka përdorur mjetet mbrojtëse personale në punë, ndërsa lëshimet e të siguruarit të paditurës janë 80 %, sepse me rastin e aksidentit nuk e ka lajmëruar Inspektoratin e punës, nuk e ka trajnuar punëmarrësin nga aspekti i mbrojtjes dhe shëndetit në punë, nuk e ka parashikuar rrezikshmërinë në vendin e punës, pastaj në vendin e lëndimit nuk ka pasur shenja paralajmëruese për ndonjë rrezik nga aspekti i mbrojtjes dhe sigurisë në punë si dhe e ka lejuar paditësin të punoj pa mjete personale të mbrojtjes në punë, prandaj nuk qëndron pretendimi ankimor i të paditurës se përgjegjësia për demin është e shumëfishtë e paditësit sepse e njëjta e ka lejuar paditësin që të

punoj pa mjetet e nevojshme të mbrojtjes dhe sigurisë në punë dhe përgjegjësia për organizmin-udhëheqjen e punëve në vend punishte i ka takuar vetëm të paditurës e cila ka pasur mundësi të parandaloj dëmin e shkaktuar tek paditësi, në qoftëse të njëjtin nuk do të lejonte të punonte pa mjete mbrojtëse, e po ashtu nga ekspertiza gjyqësore vërtetohet edhe fakti tjetër relevant se e paditura nuk e ka trajnuar paditësin nga aspekti i Mbrojtjes dhe Sigurisë në Punë dhe këto mosveprime të paditurës, me të drejt janë kualifikuar si lëshime primare në shkaktimin e aksidentit në vendin e punës.

E paditura nuk e ka kundërshtuar faktin se paditësi ka pësuar lëndime të rënda trupore, i cili lëndim është manifestuar me dhembje fizik dhe frikë, ashtu siç kanë konstatuar edhe ekspertët mjekësor në mendimin dhe konstatimin e tyre profesional, dhe në këtë kuptim gjykata e shkallës të parë drejt ka vërtetuar gjendjen faktike, për faktin se me nenin 321 paragraf 1 dhe 2 të LPK-së, përcaktohet se: “ Nuk ka nevojë të provojë faktet e ditura botërisht e as faktet që i ka vërtetuar gjykata në gjykimet e më hershme, gjykata nuk ka nevojë të provoj as faktet të cilat pala i ka pohuar para gjykatës gjatë procesit gjyqësor ”, në këtë rast e paditura i ka pohuar pothuajse të gjitha faktet e theksuara më lartë. Në këtë rast e paditura në seancën e shqyrtimit kryesor edhe pse e ka kundërshtuar pjesërisht lartësinë e kërkesëpadisë e njëjta me asnjë provë bindëse nuk ka argumentuar të kundërtën e pretendimeve nga padia, edhe pse ka pasur për detyrë ta bëjë një gjë të tillë në kuptim të nenit 7 paragraf 1 dhe 319 paragraf 1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit vlerëson se në kuptim të dispozitave materialo-juridike të lartcekura e në përputhje me gjendjen faktike të vërtetuar në këtë procedurë, për kërkesën e aprovuar në shumën sikurse në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, gjykata është e mendimit se e njëjta është adekuate, e krejt kjo duke marr parasysh ndarjen e përgjegjësisë në shkaktimin e aksidentit, dëmin që i është shkaktuar paditësit si dhe shkallën e të mirës nga e cila ai është privuar dhe se lartësia e shumës së të hollave në emër të kompensimit, do t'i mundësoj të dëmtuarit-këtu paditësit, satisfaksion që ai me këto mjete t'i riparoj në një masë nevojat e tij materiale, e po ashtu shumat e aprovuara janë në harmoni me praktiken gjyqësore të krijuara deri me tani si dhe me Udhëzimin e Gjykatës Supreme të Kosovës për caktimin e kritereve orientuese dhe lartësisë se shpërblimit të drejtë në të holla të dëmit jo material Gj.A.nr.41/2023 e dt.27/02/2023, po ashtu, Gjykatës së Apelit i kanë rezultuar si të pabazuara pretendimet ankimore të palës ankuese lidhur me aplikimin e gabuar të së drejtës materiale sepse gjykata e shkallës së parë drejt i ka aplikuar dispozitat materiale, pasi që është bazuar në gjendjen e vërtetuar faktike.

Vendimi sa i përket kamatës nga gjykata e shkallës së parë, drejtë është aplikuar e drejta materiale, lartësia e kamatës është në pajtim me nenin 382 të LMD-së, duke filluar nga data e marrjes së aktgjykimit të shkallës së parë e deri në pagesën definitive, sepse paditësi për dëmin dhe lartësinë e tij, ka ra në dijeni në momentin kur gjykata e shkallës së parë ka vendosur dhe nga ai moment kërkesa e tij për kompensim dëmi është bërë e kërkueshme dhe konsiderohet se e paditura ka ra në vonesë për përmbushjen e detyrimit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por Gjykata e Apelit nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, që do të ndikonte në ligjshmërinë e aktgjykimit, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Numri i lëndës: 2019:156816
Datë: 15.05.2024
Numri i dokumentit: 05689176

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
Ac.nr.4279/21, me datë 13/05/2024

Kryetar i kolegjit-Gjyqtari
Liridon Maloku